



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUIJE

Nr. 1351 Prot.

Data 27 / 02 / 2020

VENDIM

Nr. 47, datë 27.02 / 2020

PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR (PDyV) PËR ZONËN E RE TË ZHVILLIMIT 1,
NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJE

Në vijim të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Krujë dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 44, datë 22.01.2020 "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese"; gjithashtu në mbështetje të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për percaktimin e rregullave dhe te procedures se pershpejtuar per hartimin dhe miratimin e planit te detyruar vendor, si dhe procedures se miratimit te lejeve", kapitulli II, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 10.01.2020 "Për caktimin e Njësive Zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e viti 2020",

VENDOSA:

1. Pranimin e kërkesës nr. 1303 datë 26.02.2020, nr. 359 date 26.02.2020 nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT) për miratimin e Planit të Detyruar Vendor (PDyV) për zonën e re të zhvillimit 1, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, e shoqëruar nga Raporti i Vlerësimit Teknik të PDyV-së nr. 47/63 datë 25.02.2020 dhe dokumentacionit të plotë të PDyV-së.
2. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor (PDyV-së) për Zonën e re të zhvillimit 1, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
ARTUR BUSHI

